



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 306/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV) dega në Rahovec, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Rahovec, për shkak të vendosjes së posterave në mjetet transportuese zyrtare, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV) dega në Rahovec.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 22.10.2013, nga subjekti politik LVV dega në Rahovec, në të cilën theksohet se me datën 03 tetor 2013, diku rreth mesnatës të 02 tetorit është fotografuar mjeti transportues (kamion) i shërbimit të zjarrëfiskve, duke asistuar dhe duke e përdorur në cilësinë e mjetit ndihmës për ngjitjen e posterave të kandidatit për Kryetar Komune të Rahovecit Smajl Latifi dhe se nga kjo pretendojnë se me këtë veprim ka shkelur nenin 35 par.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 3 pika a të Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike dhe neni 3.6 për Rregullat Zgjedhore 13/2013. Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur si provë disa fotografisi si dëshmi nga vendi i ngjarjes. Ndërsa LVV ka siguruar dëshmit me datën 20 tetor 2013 me ç'rast posa kemi siguruar dëshmit kanë përgaditur ankesën pranë PZAP-së.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013, në ora 12:00 sipas afatit të caktuar. PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK, në të cilën deklaroi se ankesa në fjalë është e pabazë duke theksuar se pretendimet e LVV-së janë të pabaza lidhur me shkeljet e rregullave të përcaktuara përcaktuara me Rregulloren 11/2013 neni 3 alinea 3.3, 3.4 dhe 3.3 për thirrjen dhe lajmërimin e të gjitha strukturave dhe mbështetësve që ta rrespektojnë ligjin në fuqi dhe rregulloren e kodit të mirësjelljes. Po ashtu në përgjigjen në ankesë AAK-ja thekson se me të pranuar njoftimin ka kontraktuar strukturat menaxhuese të fushatës, konkretisht shtabin zgjedhor për Komunën e Rahovecit dhe gjithashtu Drejtorin për shërbime komunale dhe emergjente të

Komunës së Rahovecit duke vlerësuar si të padrejtë ankesën që pa asnjë fakt t'i adresohet AAK-së dhe se kërkon nga PZAP që ta hudh ankesën poshtë si të pabazë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do ti bënin të besueshme pretendimet ankimore të ankuesit pasi që mjete transportues (kamioni) për të cilin pretendon pala ankuese nga fotografitë e ofruara si dëshmi nuk shihet se ka ndonjë shenjë identifikuese se automjeti transportues i zjarrfikësve i përket ndonjë institucioni publik, andaj një pretendim të tillë të ankesës PZAP-i e vlerëson si të përgjithëshme dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, prandaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 306/2013 më datën 25.10.2013



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*